

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “ALBSIG” **Gusht 2026**

Emërtimi i Fondit: Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Albsig (“Fondi”)

Shoqëria Administruese: Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.

Monedha Bazë: Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

RREZIK I ULËT

Përfitime zakonisht të ulëta

RREZIK I LARTË

Përfitime zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 31.08.2026

Vlera Neto e Aktiveve:	1.092.236.724,19 ALL
Çmimi për kuotë:	1.234,9214 ALL
*Kthimi nga Investimit (31 Gusht 2025 - 31 Gusht 2026):	4.04%


**Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*

KOSTOT DHE TARIFAT

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	987,425,757.32	89.86
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	111,364,107.90	10.14

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


PERIUDHA: 31.08.2025-31.08.2026

Kthimi vjetor neto rezulton 4.04% për periudhën 31 Gusht 2025 – 31 Gusht 2026.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 31 Gusht 2026. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **07.02.2020**.

Albsig	5Y	3Y	2Y	1Y
Norma Vjetore e Kthimit	3.67%	4.13%	4.11%	4.04%